

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 118/23


Nr. i fq. / Br. st

Data: / Datum 07.02.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



NR.01/2023
Dt:07.02.2023

KONTRATË SHËRBIMI
(KONTRATË KORNIZË ME NJË OPERATORË EKONOMIK)

E lidhur më dt. 03.02.2023 në Vushtrri.

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson z. Ferit Idrizi – kryetari i komunës, në tekstin e mëtejme **POROSITËSI**, dhe
2. “Auto-Merimanga Andi“ SH.P.K me seli në Vushtrri, me nr. unik identifikues 811107871, si operatorë ekonomik, të cilën e përfaqëson z. Zekrija Januzi, në tekstin e mëtejme **KRYERËSI I SHËRBIMEVE**.

Lënda e kontratës: Shërbime transporti të automjeteve me auto-merimangë

Neni 1

- 1.1 **Porositësi - Komuna e Vushtrrisë**, e cila ka përcaktuar si nevojë kryerjen e shërbimeve të zhvendosjes së automjeteve në kundërvajtje në territorin e Komunës së Vushtrrisë përmes një Operatori Ekonomik, me përpilimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate i ofron Kryerësit të shërbimeve që ky i fundit të kryej: **Shërbime transporti të automjeteve me auto merimangë**, konformë dokumentacionit të ankandit publik, me ref. Nr. 01/2023, të datës 06.01.2023.

- 1.2** Në pajtim me Vendimin e tij 01 nr. 359/19 të datës 26.12.2019 dhe Vendimin 01 Nr. 263/22 dt.27.10.2022, Komuna e Vushtrrisë përkatësisht Kuvendi i Komunës, përcakton që për kryerjen e shërbimeve të zhvendosjes së automjeteve me auto-merimangë, të ofroj lokacionin në ngastrën kadastrale P-70202010-00583-1 me kulturë “kullosë e kl. 4” me sipërfaqe të përgjithshme prej 10057 m², pronë e Komunës së Vushtrrisë, parcelë kjo e cila do të shërbej për vendosjen – parkimin e automjeteve të zhvendosura ose parkingun alternativ brenda zonës së qytetit të ofruar nga kompania.
- 1.3** Shërbimi/et e transportit dhe vendosjes në vendin e caktuar të automjeteve me automerimangë, që është objekt i kësaj Kontrate, gjegjësisht implementimi konform rregullave ligjore i kësaj Kontrate do të mund të konsiderohet i rregullt dhe/ose/i e/ implementuar, vetëm në bazë të URDHËRESAVE të lëshuara nga personat kompetent të Shërbimit Policor të Kosovës dhe/ose personave të autorizuar të Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë, të cilët njëherit do të emërohen në cilësinë e Menaxherit të Kontratës.
- 1.4** Urdhëresa e lëshuar – dhënë nga personi – organi kompetent, si në pikën 1.3 të kësaj Kontrate, mund të jetë në formë të shkruar, ose në raste të caktuara emergjente edhe me gojë, por që në afatin më të shkurtër kohor duhet të mbulohet me urdhëresën me shkrim.
- 1.5** Kjo Kontratë duhet të implementohet dhe realizohet në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë, gjegjësisht Ligji mbi Sigurinë në Komunikacion, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2009-PK mbi Mënyrën e Zhvendosjes së automjeteve dhe Rregullores Komunale për Shërbimin e Transportit me auto-merimangë të automjeteve të ndaluara – parkuara në mënyrë të pa rregullt, në kundërvajtje.

Neni 2

- 2.1** Për shërbimet, në bazë të specifikimit teknik të përcaktuar si në formularin e aplikimit, Kryerësi i Shërbimeve do të faturtoj shërbimet e kryera personave – pronarëve të automjeteve të zhvendosura, sipas tarifave të përcaktuara dhe sipas çmimit të njësisë të dhëna në Formularin e Çmimeve pjesë e formularit për aplikim dhe pranuar nga të dyja palët kontraktuese, sikurse do të pasqyrohet në këtë kontratë në vazhdim.
- 2.2** Çmimet e ofruara – të kontraktuara të pasqyruara si më poshtë janë të fiksuara dhe të pandryshuara, nuk mund të jenë lëndë e ndryshimit dhe / ose negociimit nga asnjëra palë të cilat mund të kontraktohen dhe / ose faturohen shërbimet e kryera nga Kryerësi i Shërbimeve, me sa vijon :

2.3 Çmimore e shërbimeve të kontraktuara dhe provizioni :

Nr.	Përshkrimi i llojit të shërbimeve	Njësia	Çmimi-tarifat sipas Udhëzimit Administrativ 02/2009-PK i shprehur në vlerë Financiare (€)	Çmimi (provizion) Për Operatorin Ekonomik (€)	Çmimi i ofruar (provizioni) për Autoritetin Kontraktues, i shprehur në (€)
1	Kompensimi për tërheqjen e automjeteve brenda zonës së qytetit duke përfshirë: motoçikletë, traktor pa rimorkio, veturë nga zhvendosja deri në vendin për vendosje dhe ruajtje deri 24 orë.	Copë	30.00 €	27.00 €	3.00 €
1.1	Tërheqja e automjetit transportues, rimorkios ose gjysmë rimorkios dhe autobusit brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtja e tyre deri në 24 orë.	Copë	100.0 €	90.00 €	10.00 €
2.	Zhvendosja e automjeteve nga paragrafi 1 i pikës 9.1, nga zona jashtë qytetit, pa ngarkesë i shtohet vlera 0.25€, ndërsa me ngarkesë 0.50 € për 1 km. Të njëjtat tarifa vlejné edhe për paragrafin 2. të pikës 9.1.	Copë	0.25 €	0.20 €	0.05 €

2.1	Zhvendosja e automjeteve nga paragrafi 1 i pikës 9.1, nga zona jashtë qytetit, me ngarkesë 0.50 € për 1 km. Të njëjtat tarifa vlejné edhe për paragrafin 2. të pikës 9.1.	Copë	0.50 €	0.45 €	0.05 €
3	Në rastin kur zhvendosja e automjetit fillon, por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e ruajtjes, zbatohet çmimi si vijon: në zonën urbane 15 €, ndërsa jashtë zonës urbane zbatohet paragrafi i pikës 9.2.	Copë	15.00 €	13.50 €	1.50 €
4	Kur automjeti i zhvendosur pas kalimit të kohës prej njëzet e katër orësh, nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi siç përcaktohet në këtë Rregullore, ruajtja, përkatësisht qëndrimi i mëtutjeshëm i automjetit për një ditë qëndrimi dhe ruajtje (24hx0.42)=10€	Copë	10.00 €	9.00 €	1.00 €
5	Për zhbllokimin e automjeteve, autobusëve, automjeteve transportuese, automjeteve të punës dhe automjeteve të punës dhe rimorkiove	Copë	15.00 €	13.50 €	1.50 €
6	Kompensimi për tërheqjen e automjeteve dhe tentativën për tërheqje të automjeteve të braktisura brenda zonës së qytetit, operatorit Ekonomik i behet nga buxheti i dedikuar për Komunën e Vushtrisë prej tërheqjes së realizuar nga Operatori ekonomik	Copë	15.00 €	13.50 €	1.50 €

Neni 3

- 3.1 Kryerësi i Shërbimeve merr për obligim që të siguroj dokumentacionin për faturim të shërbimeve. Bllokat e faturave, të cilat do të jenë me barkod dhe numër serik, aprovohen nga Zyrtari Komunal Kompetent z. Islam Latifi.
- 3.2 Çdo taksë e faturuar nga Kryerësi i Shërbimeve, e inkasuar mbi bazën e kryerjes së shërbimit, sipas Urdhëresës së Shërbimit Policor të Kosovës dhe / ose Kërkesës së personit të autorizuar të Komunës së Vushtrisë, do të ekzekutohet vetëm përmes procedurave bankare.
- 3.3 Mjetet financiare në emër të taksës për shërbimin – tërheqjen e automjetit e në kundërvajtje, pika 1, 1.1, 2, 2.1 dhe 3 e Çmimoreve sipas kësaj Kontrate – **pjesa e provizionit për Autoritetin Kontraktues nga Kryerësi i Shërbimeve**, do të faturohet në mënyrë të veçantë dhe në shumën e paraparë me këtë Kontratë, në barrë të pronarit të automjetit të zhvendosur, ndërsa mjetet duhet të derdhen në llogarinë bankare të Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrisë:- **1000650310000041 – Banka Qendrore e Kosovës.**
- 3.4 Mjetet financiare në emër të taksës për shërbimin – tërheqjen e automjetit në kundërvajtje, sipas Çmimoreve në këtë Kontratë për të gjitha pikat, **pjesa e provizionit për Kryerësin e shërbimeve nga Kryerësi i Shërbimeve** do të faturohet në mënyrë të veçantë dhe në shumën e paraparë me këtë Kontratë, në barrë të pronarit të automjetit të zhvendosur, ndërsa mjetet duhet të derdhen në llogarinë bankare të Kryerësit të Shërbimeve – “Auto-Merimanga Andi” SH.P.K me seli në Vushtri, nr i Llogarisë Bankare:- 1405000004862298 pranë Banka Ekonomike sh.a. Prishtinë.
- 3.5 Mjetet financiare në emër të taksës për shërbimin nga **pika 4, 5 dhe 6** të Çmimoreve si në këtë Kontratë,- **pjesa e provizionit për Autoritetin Kontraktues, nga Kryerësi i Shërbimeve**, do të faturohet në shumën e paraparë me këtë Kontratë dhe në barrë të pronarit të automjetit të zhvendosur ndërsa mjetet do të derdhen në llogarinë bankare të Autoritet Kontraktues – Komunës së Vushtrisë:- **1000650310000041- Banka Qendrore e Kosovës.**
- 3.6 Mjetet financiare në emër të taksës për shërbimin nga **pika 4, 5 dhe 6** të Çmimoreve si në këtë Kontratë, - pjesa e provizionit për Kryerësin e Shërbimeve nga Kryerësi i Shërbimeve, do të faturohet në shumën e paraparë me këtë Kontratë dhe në barrë

të pronarit të automjetit të zhvendosur në shumën e paraparë me këtë Kontratë dhe në barrë të pronarit të automjetit të zhvendosur ndërsa mjetet do të derdhen në llogarinë bankare të Kryerësit të Shërbimeve: "Auto-Merimanga Andi" SH.P.K me seli në Vushtrri, nr. i Llogarisë Bankare:- 1405000004862298 pranë Banka Ekonomike sh.a. Prishtinë.

- 3.7** Automjetet e zhvendosura të cilat në autoparkun e Kryerësit të Shërbimeve kanë qëndruar mbi gjashtë muaj, dhe në bazë të gjendjes së tyre teknike kanë plotësuar kushtet sipas nenit 9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2009-PK Rregullores Komunale për Shërbimin e Transportit me merimangë për Territorin e Komunës së Vushtrrisë, në pajtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, do të procedohen (shiten) për në deponi të mbeturinave të hekurit.
- 3.8.** Mjetet e realizuara nga shitja e automjeteve të zhvendosura dhe të shitura sikurse u theksua në pikën paraprake të këtij neni do të depozitohen në llogarinë bankare të përfituesit/ve, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë çështje, duke pasur parasysh këtu dhe riskun që bartë Kryerësi i Shërbimeve për periudhën e mbajtjes, ruajtjes së automjetit dhe pamundësisë së faturimit gjegjësisht inkasimit të mjeteve në emër të zhvendosjes dhe ruajtjes së automjetit.
- 3.9** Çdo bllok i shpenzuar, në afatin prej 2 (dy) ditësh kalendarike, duhet t'i kthehet Autoritetit Kontraktues, respektivisht zyrës e cila ka bërë dorëzimin e bllokave për faturim.

Neni 4

- 4.1** Ashtu sikurse është përcaktuar dhe në Specifikimin Teknik të Formularit për Aplikim, Kryerësi i Shërbimeve para fillimit të ekzekutimit të shërbimeve merr për obligim që me mjete vetanake, pa asnjë detyrim të Autoritetit Kontraktues për kompensim të këtyre investimeve, të investoj në rregullimin e hapësirës – objektit në parcelën e ofruar si në nenin 1 të kësaj Kontrate, ose parkingun alternativ brenda zonës së qytetit të ofruar nga kompania ku do të vendosen automjetet e zhvendosura.
- 4.2** Parcela e paraparë për vendosjen e automjeteve të zhvendosura është pronë e Komunës së Vushtrrisë e cila për destinim të caktuar ka vendosjen e automjeteve të zhvendosura, i jepet në shfrytëzim pa kompensim Kryerësit të Shërbimeve, për një periudhë prej 24 muajsh, pas kryerjes së investimeve të nevojshme për funksionalizimin e hapësirës, rregullimin dhe aftësimin për pranim të automjeteve, ose rregullimin e parkingut alternativ brenda zonës së qytetit të ofruar nga

kompania konformë vlerësimit përfundimtar të Menaxherit të Kontratës të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

- 4.3 Investimet e nevojshme për funksionalizimin dhe aftësimin e hapësirës për vendosjen e automjeteve të zhvendosura bien në barrë të Kryerësit të Shërbimeve dhe nuk mund të jenë, në asnjë rrethanë, objekt i diskutimit për ndonjë formë të kompensimit, gjatë ose pas përfundimit të kontratës.
- 4.4 Kryerësi i shërbimeve është i obliguar dhe pajtohet që të paguaj si pagesë të rregullta paraprake edhe kostot vijuese dhe ngarkesat që kanë të bëjnë me :
- 4.4.1 Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit, duke përfshirë këtu mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirës së autoparkut,
- 4.4.2 Faturimin për bartjen e mbeturinave për objektin në shfrytëzim,
- 4.4.3 Furnizimin me ujë,
- 4.4.4 Kanalizimit,
- 4.4.5 Rrymës elektrike për objektin në shfrytëzim.
- 4.5 Kryerësi i Shërbimeve është i obliguar që për shkak të specifikave dhe natyrës së punëve të cilat janë objekt i zbatimit sipas kësaj Kontrate, në objekt të krijoj kushte të vendosjes dhe qëndrimit të personelit në kohë të pandërprerë 24 orë dhe 7 ditë punë javore.
- 4.6 Kryerësi i Shërbimeve po ashtu merr për obligim që gjitha pajisjet e tij, pajisjes për zhvendosje të automjeteve (radiolidhjet dhe telefonin celular) t'i mbajë në gjendje teknike të rregullt gjatë gjithë kohës.
- 4.7 Kryerësi i Shërbimeve merr për obligim që me të filluar të ekzekutimit të shërbimeve të mbaj librin e evidencës në të cilin, në mënyrë të rregullt dhe në baza ditore, do të mbajë evidencën e saktë me të dhënat e automjeteve të cilat hyjnë dhe dalin nga objekti gjegjësisht lokacioni ku janë zhvendosur automjetet. Libri i evidencës do të jetë objekt i monitorimit dhe kontrollit nga ana e personave kompetent të Shërbimit Policorë të Kosovës dhe / ose Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë, në çdo kohë dhe pa asnjë kushtëzim.
- 4.8 Afati për fillimin e punimeve është 1 (një) ditë pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 4.9 Afati i përfundimit të punëve – investimeve të nevojshme për funksionalizimin dhe aftësimin e hapësirës qoftë parcelën në pronën komunale qoftë hapësirën e ofruar

nga operatori ekonomik për pranim – vendosje të automjeteve të zhvendosura është jo më gjatë se 20 (njëzetë) ditë kalendarike nga dita e fillimit të punimeve.

- 4.10 Kryerësi i Shërbimeve ka të drejtë në shtyerje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Punëdhënësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

Neni 5

- 5.1 **Kontrata për kryerjen e shërbimeve të specifikuar si në nenin një është e lidhur për një periudhë prej 24 muajve.**
- 5.2 Realizimi i shërbimeve kontraktuese, që i referohet ekzekutimit të zhvendosjes – bartjes së automjeteve në kundërvajtje fillon një ditë pas konfirmimit me shkrim nga ana e Menaxherit të Kontratës të Autoritet Kontraktues z. Islam Latifi se hapësira e caktuar për vendosje të automjeteve të zhvendosura është rregulluar, funksionalizuar për pranim dhe vendosje të automjeteve të zhvendosura.

Neni 6

- 6.1 Shërbimet duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në formularin për aplikim, të bazuara në Rregulloren Komunale për Shërbimin e Transportit me merimangë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2009 – PK mbi mënyrën e zhvendosjes së automjeteve.
- 6.2 Kryerësi i shërbimeve po ashtu garanton dhe siguron qëndrimin e automjeteve në autopark dhe përkujdesjen ndaj tij/tyre gjatë gjithë kohës derisa automjeti, nga ana e pronarit, të tërhiqet nga autoparku.
- 6.3 Për çdo parregullsi dhe / ose dëmtim të automjetit/ve, e të cilat mund të t'i atribuohen pakujdesisë dhe/ose fajësisë së Kryerësit të Shërbimeve, dhe të cilat kanë implikime financiare dhe ose civile, bartës i përgjegjësive ndaj pronarit të automjetit të zhvendosur do të jetë Kryerësi i Shërbimeve.

Neni 7

- 7.1 Shërbimet të cilat përbëjnë lëndën e kësaj Kontrate dhe që në mënyrë të rregullt urdhërohen për ekzekutim nga organi kompetent – Shërbimi Policor i Kosovës dhe / ose personi zyrtar i Komunës së Vushtrisë, konformë nenit të 1 të kësaj Kontrate, duhen të përfundohen në pajtueshmëri të plotë me kushtet e Kontratës, në aspektin cilësor dhe brenda afatit kohor të arsyeshëm (menjëherë) pas marrjes së Urdhërit – Kërkesës nga organet në fjalë.

- 7.2 Për çdo vonesë të Kryerësit të Shërbimeve në përmbushjen e shërbimit/ve të përcaktuara si në dispozitat e kësaj Kontrate, Porositësi do të aplikoj penale për çdo ditë vonuar në masën – shumën prej 0.25% të vlerës së shërbimeve të pa përfunduara.
- 7.3 Në rast se Kryerësi i Shërbimit dështon në përmbushjen e detyrimit/ve të marra sipas Urdhëresës, Autoriteti Kontraktues mbanë të drejtën ta ndërpresë pjesërisht ose tërësisht Kontratën. Në rast të ndërprerjes së tillë, Porositësi gjegjësisht Autoriteti Kontraktues do të caktoj datën efektive të përfundimit të Kontratës dhe të udhëzoj Kryerësin e Shërbimeve për hapat e ardhshëm që duhet t'i ndërmarr deri në atë datë.
- 7.4 Nëse ndërprerja e Kontratës bëhet për shkak të shkeljes së Kontratës nga Kryerësi i Shërbimeve, atëherë Porositësi do të ketë të drejtë që në pajtim me dispozitat e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nga Kryerësi i Shërbimeve t'i kompensoj të gjitha shpenzimet e dokumentuara të shkaktuara drejtpërsëdrejti nga veprimet dhe/ose mos veprimet e Kryerësit të Shërbimeve.

Neni 8

- 8.1 Me qëllim të përcjelljes së zbatimit të rregullt të Kontratës, Autoriteti Kontraktues do të emëroj Menaxherin e Kontratës i cili është z. Islam Latifi.
- 8.2 Menaxheri i Kontratës do të bashkëpunoj ngushtë dhe në mënyrë të plotë me organet dhe personat kompetent që do të jetësojnë zbatimin e Kontratës dhe në baza kohore të arsyeshme ose sipas kërkesës, do t'i informoj organet kompetente të Autoritetit Kontraktues për efektet dhe rrjedhën e zbatimit të kësaj kontrate.

Neni 9

- 9.1 Kontraktuesit pajtohen se janë të një mendimi për dispozitat e kësaj kontrate, andaj heqin dorë nga zgjedhja e njëanshme e saj.
- 9.2 Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë gjykata kompetente sipas ligjit, ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në dokumentacionin – Formularit për Aplikim me ref.nr. 01/2023 të datës 06.01.2023 dhe / ose dispozitat e Rregullores Komunale për Shërbimin e Transportit me merimangë 139/11, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Komunale 139/11K për Shërbimin e Transportit me merimangë 139/11 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2009 – PK mbi mënyrën e zhvendosjes së automjeteve.
- 9.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do të marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Veçanta

dhe/ose në Kushtet e Përgjithshme të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e FORMULARIT PER APLIKIM.

Neni 10

- 10.1** Porositësi nuk ka të drejtë, në asnjë rrethanë të publikoj asnjë informacion që i referohet Autoritetit Kontraktues pa aprovimin paraprak me shkrim të tij.
- 10.2** Të gjitha komunikimet në mes Porositësit - Menaxherit të Kontratës, nga njëra anë dhe Kryerësit të Shërbimeve, nga ana tjetër do të konsiderohen se janë të rregullta vetëm nëse janë bërë me shkrim. Shkresat e tilla duhen të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj dhe duhet të dërgohen me postë, adresa: Komuna Vushtri Sheshi "Ahmet Krasniqi".

Neni 11

- 11.1** Kjo kontratë është përpiluar në **5 (pesë)** kopje origjinale, nga të cilat **2 (dy)** origjinale për Porositësin dhe **1 (një)** origjinal për Kryerësin e Shërbimeve dhe **2 (dy)** origjinal për Shërbimin Policor të Kosovës – Vushtri.
- 11.2** Për zbatimin e kësaj Kontrate do të kujdesen: **Drejtoria Komunale për Shërbime Publike, Drejtoria Komunale për punë të Inspektionit, Policia e Kosovës dhe Kryerësi i Shërbimeve.**

Për saktësinë e të dhënave në Kontratë dhe përshtatshmërisë së tyre në bazë të procedurës në pajtim me dispozitat ligjore vërteton :

Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale

Kryetari i Komisionit



Benjamin Shala

KONTRAKTUESIT

Për Kryerësin e Shërbimeve,



Zekrija Januzi

Kryetari i komunës,



Ferit Idrizi